



REPUBLIKA E SHOIPËRISË

BASHKIA TIRANË

ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE

“Eficenca mjedisore në Qytet Studenti”

Tiranë, 2024

PROCESVERBAL

Mbledhur sot më datë 01.02.2024, mbi bazën e Memos Nr. 2140 prot, datë 17.01.2024 me objekt: “Kërkesë për miratimin mbi realizimin e procedurës dhe ngritjen e grupit të punës për projektin “Efiçenca Mjedisore në Qytet Studenti”, si dhe Urdhërit të Zv/Kryetares të Bashkisë Tiranë me Nr. 3057 prot, datë 22.01.2024 dhe Nr. 81 për “Ngritjen e Grupit të Punës dhe Përgatitjen e Termave të Referencës dhe Përcaktimin e Fondit Limit, konform legjislacionit në fuqi për realizimin e procedurës “Efiçensa Mjedisore në Qytet Studenti”, përcaktimin e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit për realizimin e tenderit për këtë objekt.

Çdo zhvillim dhe përgatitje të dokumentacionit është realizuar mbi bazën e eksperiencës së përgatitjes së dokumentacionit në procedura të ngjashme.

1. HYRJE

Në kuadër të vlerësimit të situatës aktuale të disa godinave të “Qytetit Studenti”, si dhe fokusit për arritjen e një sërë objektivash strategjike mbi hapësirat e gjëlbertha dhe kursimin e energjisë elektrike, Bashkia Tiranë (Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm) ka ndërmarrë një nismë nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një projekti që pritet të japi një rezultat efektiv dhe të kënaqshëm në lidhje me kursimin e energjisë elektrike si dhe sensibilizimin e studenteve për ruajtjen e mjedisit.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1 Objektivi i përgjithshëm

Ky projekt ka si objektiv të përgjithshëm prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjise, e cila është energji e pastër që ndikon në uljen e emetimeve të CO2 si dhe në rritjen e efikasitetit energjitik dhe mjedisore, si dhe zbatimin e metodave efikase për menaxhimin e mbetjeve ushqimore.

2.2 Qëllimi

Qëllimi i vënies në zbatim të këtij projekti është shfrytëzimi i hapësirës së taracës së godinës nr.11 për instalimin e paneleve fotovoltaike të cilat do të mundësojnë prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet rrezatimit diellor duke minimizuar kështu konsumin e energjisë elektrike të marrë nga rrjeti, si dhe duke rritur efikasitetin e godinës, si nga ana energjitike ashtu dhe mjedisore. Gjithashtu, në fokus të këtij projekti është edhe informimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve nëpërmjet promovimit të praktikave më pak të dëmshme për mjedisin, duke sjellë në këtë mënyrë një përballje më efikase në lidhje me sfidat mjedisore që ndeshemi shpesh në përditshmërinë tonë.

Një tjetër fokus i këtij projekti është edhe menaxhimi me efikasitet i mbetjeve duke realizuar ndarjen e tyre që në burim.

Referuar vendit specifik ku do të implementohet ky projekt rezulton që kemi të përfshirë dy godina me nga 5 kate secila ku të dy godinat janë të lidhura me njëra-tjetrën me një seksion me një kat. Të dy godinat janë të organizuara në apartamente me dy dhoma, me një nyje hidrosanitare për të dy dhomat. Në çdo dhomë janë dy deri në tre studentë. Në çdo kat ka 49 studentë dhe në total për të dy godinat janë 450 studentë. Janë gjithsej 120 tualete në të dy godinat, ku në çdo kat ka 12 tualete në çdo godinë. Në çdo tualet ka dalje dushi dhe lavaman. Ndërkohë që, në çdo kat ka nga një ambient kuzhine me dalje lavamani. Gjithsej, në të dy godinat ka 10 guzhina.

Në kuadër të këtij organizimi një pjesë tjetër që do të ndërhyhet në secilin kat të çdo godine do të vendosen 4 kosha me tipologji me katër ngjyra të ndryshme (plastike /alumin/ letër/ mbetje organike) të cilët do të jenë me kapacitet prej 80 litra çdo kosh, si dhe katër kosha do të vendosen jashtë çdo godine me një kapacitet prej 120 litra secili kosh. Ky organizim do të na

sigurojë një efektivitet më të lartë lidhur me ndarjen e mbetjeve në bazë të kategorive. Referuar raportimeve, nga të dy këto godina kemi një akumulim prej 2.3 m³ mbetje në ditë.

Pra, në thelb fokusi i këtij projekti është ulja e konsumit të energjisë elektrike si dhe zbatimi i disa metodave më efektive për mirëmenaxhimin e mbetjeve, pra rritja e efikasitetit mjedisor dhe energjitik të godinave.

a. Rezultatet që duhet të arrihen nga kontraktori

- Zhvillimi i fushatës sensibilizuese me fokus ndërgjegjësimin e brezave të rinj lidhur me mbrojtjen e mjedisit gjatë përditshmërisë së tyre.
- Rritja e efikasitetit energjitik dhe ulja e konsumit të energjisë së marrë nga rrjeti duke shfrytëzuar sipërfaqen e godinës nr.11 për të instaluar panele për prodhimin e energjisë nga dielli. Panelet që do të instalohen të jenë prodhim evropian dhe të garantojnë cilësinë dhe jetëgjatësinë e sistemit.
- Grumbullimi me efikasitet dhe saktësi i mbetjeve ushqimore/ plastike/ alumin/ letër dhe pozicionimi i këtyre mbetjeve në vendet përkatëse të grumbullimit të tyre sipas kategorisë.
- Promovimi i praktikave më të mira dhe më pak të dëmshme për mjedisin.

➤ Përshkrimi i detyrës

- Bashkëveprimi me QS për shkëmbimin e informacioneve specifike lidhur me mënyrën e organizimit të godinave 11 dhe 12 (numrin e kateve, dhomave, numrin e studentëve, sasinë e mbetjeve ditore të prodhuara në të dy godinat, konsumin e energjisë për secilën godinë etj).
- Organizimi i zhvillimit të sesioneve informuese tek studentët nëpërmjet realizimit të trajnimeve lidhur me adaptimin e praktikave më pak të dëmshme për mjedisin si dhe informimi dhe ndërgjegjësimi mbi efikasitetin energjitik nga ekspertë të fushës së mjedisit dhe efikasitetit të energjisë.
- Vënia në dispozicion e bazës materiale për ndarjen në burim të mbetjeve që gjenerohen nga dy godinat e “Qytet Studenti” respektivisht godina nr. 11 dhe 12.
- Instalimi i paneleve fotovoltaike për tarracën e godinës nr.11.
- Zhvillimi i një konference përmblyëse me fokus përfshirjen sa më të gjerë të profesionistëve të lidhur me fushën e mjedisit dhe energjisë.

Hapësira gjeografike që do të mbulohet

- Ky projekt do të implementohet në mesin e “Qytet Studenti” konkretisht godina Nr. 11 dhe 12.

3. KËRKESA SPECIFIKE PËR REALIZIMIN E SHËRBIMIT

b. Stafi dhe ekspertë të punësuar ose të kontraktuar

- Ekspertë trajnues (ekspertë mjedisi / inxhinier mjedisi ose në fusha të tjera të ngjashme).
- Inxhinier elektrik
- Specialist elektrikist
- Punëtor për transportim dhe montim të paneleve diellore
- Kordinator projekti për takimet në “Qytet Studenti”
- Menaxher i energjisë.

4. LOGJISTIKA DHE KOHA

a. Vendndodhja

Tiranë, Bashkia Tiranë

b. Data e fillimit dhe periudha e implementimit të detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës.

Preventiv			
Nr	Emërtimi/Përshkrimi	Sasia	Njësia
1	Panele fotovoltaik	200	Copë
2	Inverter fotovoltaik	1	Copë
3	Modul monitorimi	1	Copë
4	Kuadër shpërndarje	1	Copë
5	Kabëll solar 1x6 mm ²	1000	m
6	Kabëll elektrik 90 mm ²	90	m
7	Aksesor elektrik	1	Set
8	Sistem montimi	1	Set
9	Aksesorë montimi	710	Copë
10	Transport, montim, komisionim	1	Shërbim
11	Kosha me tipologji me 4 ngjyra perkatësisht plastik/alumin/letër/mbetje organike me kapacitet 80 litra	40	Copë
12	Kosha me tipologji me 4 ngjyra perkatësisht plastik/alumin/letër/mbetje organike me kapacitet 120 litra	8	Copë
13	Qese me kapacitet 80 litra	150	Pako
14	Qese me kapacitet 120 litra	150	Pako
15	Menaxher energjie	1	Person
16	Ekspert trajnues mjedisi	1	Person
17	Kordinator projekti për takimet në “Qytet Studenti”	1	Person
21	Organizimi i konferences përmbyllese (ekspert të organizatave të ndryshme me fokus mjedisin, organizator, shpenzime logjistike si qera salle, foni, katering, ekran led)	1	Shërbim
TOTAL PA TVSH			
TVSH			
TOTAL ME TVSH			

Për studentët që frekuentojnë ambientet e zonës “Qytet Studenti”, do të zhvillohen trajnime lidhur me:

- Ofrimin e informacioneve mbi rëndësinë e ndarjes në burim të mbetjeve si proces.
- Ndërgjegjësimin e ndarjes së mbeturinave sipas kategorive specifike plastikë/ alumin/ mbetje organike/letër. Kjo ndarje të bëhet përkatësisht në koshat me ngjyra të ndryshme: për *materialet plastike* duhen koshat me *ngjyrë blu*, për *mbetjet organike* duhen koshat me *ngjyrë të verdhë*, për materialet *e letrës* duhen koshat me *ngjyrë jeshile* dhe për materialet *alumin* duhen koshat *me ngjyrë kafe*. Në secilin kosh duhet të jetë shënuar në pjesën e jashtme emërtesa përkatëse e kategorisë së mbetjes që do përmbajë ai. Shkrimi duhet të jetë i qartë, i lexueshëm, me ngjyrë të bardhë me madhësi të përshtatshme sipas madhësisë së koshit.
- Demonstrimi i metodës në formë të thjeshtëzuar e këtij procesi në mjedis.

- Organizimi i nje pyetësori duke vlerësuar nismën e Bashkisë Tiranë mbi kategorizimin e mbeturinave parë nga këndvështrimi i studentëve si dhe marrja e informacioneve mbi mundësitë e reja për përmirësime dhe investime në këtë fushë.

Për ekspertët trajnues (1) në profil inxhinier mjedisi/ inxhinier kimist ose në profile të tjera të ngjashme, autoriteti i kontraktuar duhet të paraqesë: Diplomë/ certifikatë kualifikimi me profesion/ kimist/ inxhinier mjedisi ose në profile të ngjashme. Kontratë pune përkatëse-librezë pune- duhet të ketë eksperiencë pune. Të paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore, individuale e lëshuar nga e-albania. –Eksperti i mësipërm nëse është i punësuar njëkohësisht në sektorin privat apo publik, duhet të paraqesë deklaratën përkatëse.

Si element kyç në këtë projekt do të jetë organizimi i konferencës përmblylëse, ku do të marrin pjesë ekspertë të fushës së mjedisit që do të jenë përfaqësues të organizatave të ndryshme. Për zhvillimin e kësaj konference nevojiten edhe disa elementë të tjerë të nevojshëm: si një ambient i marrë me qera për zhvillimin e saj, nevojitet mundësimi i fonisë (mikrofoni dhe pajisje të tjera përkatëse), sigurimi i ushqimit (dhe kafe) me catering për pjesëmarrësit/ të ftuarit, si dhe ekran led për të kryer prezantimet që do të paraqiten. Finalizimi i gjithë këtij projekti do të jetë një hallkë e rëndësishme për vijueshmërinë e investimeve në këtë fushë.

Në kuadër të nismës për minimizimin e konsumit të energjisë elektrike është e nevojshme kontraktimi i një specialisti si më poshtë:

Për specialistin elektrikist një (1) person duhet të plotësohen kriteret si më poshtë:

Arsimi i mesëm profesional, përvojë pune në organizata të industrisë elektrike. Arsimi i lartë (Inxhinier Elektrik), të paktën 1 vit përvojë pune në organizata të industrisë elektrike.

Njohja e standardeve bazë elektrike për vendosjen e pajisjeve elektrike, metodat e kontrollit dhe matjes së tyre. Aftësia për të përdorur instrumente, pajisje dhe vegla të përdorura për të matur dhe testuar pajisjet elektrike; Aftësia për të kryer teste parandaluese, matje dhe rregullim të pajisjeve elektrike; Aftësia për të kryer riparime të vogla të instrumenteve dhe pajisjeve të automatizimit të përdorura në matjen dhe testimin e pajisjeve elektrike; Leximi i qarqeve elektrike. Specialisti duhet të kryejë/asistojë që të çojë në minimizimin e konsumit të energjisë elektrike.

Duke qenë se ky investim konsiston në rritjen e efikasitetit mjedisore dhe energjitike gjatë periudhës së implementimit të këtij projekti duhet që i kontraktuari të ketë pjesë të stafit të tij 1 person të certifikuar si Menaxher Energjie, i cili do të përgatisë një raport në lidhje me konsumin aktual të godinës dhe parashikim për ulje të konsumit. Personi i kontraktuar në këtë pozicion duhet të ketë arsimin e lartë në inxhinieri mekanike, elektrike, fizike, elektronike, arkitekturë, urbanistikë, inxhinieri ndërtimi, inxhinieri mjedisi, shkencat e fizikës, mjedisit dhe kimisë industriale, inxhinieri ekonomike ose në fusha të tjera të ngjashme. Personi duhet të jetë i pajtur me certifikatën përkatëse të menaxherit të energjisë të lëshuar nga “Agjencia e Eficencës së Energjisë” dhe duhet të ketë eksperiencë pune në profil.

Gjithashtu, është konsideruar si element i rëndësishëm edhe kontraktimi i një ofruesi shërbimi përgjegjës për transportimin dhe montimin e paneleve diellore. Siguria e produktit, informacioni mbi përdorimin me efikasitet të tij dhe asistenca e këtij ofruesi shërbimi gjatë

marrjes së këtyre paneleve dhe realizimi i montimit të tyre do të na cojë në një menaxhim të mirë të kësaj procedure.

Për instalimin e paneleve diellorë i kontraktuari duhet të marrë masa që përveç pajisjeve të parashikuara duhet të asistojë me cdo element tjetër (pajisje/ vegla pune) të nevojshme për kryerjen e procedurës.

Në përfundim të gjithë kësaj nisme, si dhe informacioneve të akumuluar nga aktorë të ndryshëm të përfshirë në këtë nismë, grupi i punës do të hartojë një relacion përfundimtar mbi objektivat e arritura.

Etapat e ndjekjes së projektit

- Puna parapërgatitore mbledhja e informacionit dhe përgatitja e projektit fotovoltaik për tarracën e godinës nr. 11.
 1. Puna paraprahe mbi identifikimin e pikave strategjike ku do të zbatohet projekti.
 2. Identifikimi i ndërhyrjeve që do të kryhen (vendosja e koshave për mbetje të ndryshme, instalimi i paneleve, zhvillimi i fushatës sensibilizuese tek studentët).
- Puna në terren
 1. Zhvillimi i fushatës sensibilizuese në QS.
 2. Instalimi i paneleve diellore në tarracën e godinës nr.11.
 3. Vendosja e koshave të mbetjeve brenda dhe jashtë godinave të parashikuara.
- Puna finalizuese
 1. Zhvillimi i konferencës përmbyllëse.
 2. Përgatitja e një relacioni përfundimtar.

Pas përfundimit të secilës prej etapave të mësipërme, i kontraktuari duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor raport të detajuar mbi vijueshmërinë e punës.

<u>Nr. i Etapave</u>	<u>Kohëzgjatja</u>
1. Puna parapërgatitore	2 muaj nga nënshkrimi i kontrtatës
2. Puna në terren	2 muaj pas përfundimit të fazës përgatitore
3. Puna finalizuese	2 Muaj pas punës në terren

Në total ky projekt do të ketë një kohëzgjatje prej 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Punoi: Ky projekt do të funksionojë sipas Urdhrit me Nr. Prot 3057, datë 22/01/2024 dhe Nr. rendor 81 “Për Ngritjen e Grupit të Punës për Përgatitjen e Termave të Referencës dhe Përcaktimin e Fondit Limit, konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit me objekt “Eficienca mjedisore në Qytet Studenti””.

GRUPI I PUNËS